



I dedikuar për cilësi, standarde dhe suksese
Dedicated for quality, standards and excellences
Posvecen kualitetu, standardima i uspjehu

Raport përmbledhës i rezultateve të vlerësimit nga pyetëtori
“Studenti Administratën”

Semestri dimëror 2024/2025

Qëllimi i vlerësimit

Përmes pyetësorit “Studenti Administratën”, studentët kanë mundësinë të vlerësojnë komunikimin me administratën, sjelljen, gatishmërinë për t’i këshilluar, disponueshmërinë në kohën kur atyre ju nevojitet, dhe përmbushjen e kërkesave të tyre. Qëllimi i vlerësimit të administratës nga studentët është të ndihmojë universitetin në identifikimin e çështjeve dhe sfidave në shërbimin ndaj studentëve, dhe në përmirësimin e proceseve dhe politikave për t’u përshtatur më mirë me nevojat e studentëve.

Metodologjia e punës

Ashtu siç është e paraparë në Kalendarin e aktiviteteve të Udhëzuesit për sigurim të cilësisë, në fund të secilit semestër, studentët plotësojnë pyetësorin “Studenti – Administratën”, për të vlerësuar shërbimet administrative të universitetit. Pyetësori është përbërë nga 3 pyetje me mundësi të përgjigjes në shkallë nga 1 deri në 5 (1* dobët, 2* mjaftueshëm, 3* mirë, 4* shumë mirë, 5* shkëlqyeshëm), për zyrët apo shërbimet që studenti merr apo pranon nga administrata. 3 pyetje me përgjigje alternative dhe në fund fare studentët kanë pasur mundësinë të shprehën lirshëm duke dhënë sugjerime dhe vërejtje për shërbimet e ofruara nga administrata.

Procesi i vlerësimit

Pyetësori “Studenti – Administratën”, është shpërndarë përmes sistemit elektronik SEVC. Procesi i vlerësimit në të pesë njësitë akademike, për semestrin dimëror 2024/2025, është realizuar gjatë periudhës së paraqitjes së provimeve, duke filluar me datë 14 janar dhe ka zgjatë deri me 23 janar, dhe janë plotësuar gjithsej 1313 pyetësorë.

Me fillimin e procesit të vlerësimit, studentët janë njoftuar me rregullat e përgjithshme të këtij procesi, duke i garantuar ata se pyetësorët janë anonim dhe se ata mund të shprehin lirshëm atë që mendojnë për shërbimet administrative. Pas përfundimit të periudhës vlerësuese, të dhënat janë mbledhur dhe përpunuar, të cilat janë analizuar nga Komisionet për sigurim të cilësisë dhe vlerësim në nivel të njësive akademike dhe nga Këshilli për Menaxhim të Cilësisë dhe Vlerësim në nivel qendror. Bazuar në gjetjet nga rezultatet e vlerësimit janë dhënë rekomandimet për përmirësim.

Rezultatet e vlerësimit

1. Se si preferojnë studentët të komunikojnë me administratë, tregojnë rezultatet si në vijim: 761 apo 58% të studentëve preferojnë të komunikojnë me administratë fizikisht, 482 apo 36% prej tyre preferojnë të komunikojnë përmes e-mailit, ndërsa 83 apo 6% e tyre përmes telefonit (figura 1).




Figura 1

2. A punon biblioteka me orar të përshtatshëm, studentët kanë vlerësuar si në vijim: 996 studentë apo 75% pohojnë se biblioteka punon me orar të përshtatshëm për studentë, 77 studentë apo 6% nuk pajtohen që biblioteka punon me orar të përshtatshëm, ndërsa 253 apo 19% nuk e frekuentojnë bibliotekën fare (figura 2).




Figura 2

3. Sipas rezultateve të paraqitura, 917 apo 69% të studentëve për të drejtat e tyre dhe shërbimet studentore informohen nga Zyrtarët për çështje studentore (Referentët), ndërsa 409 apo 31% nga Sekretarët e njësisë akademike (figura 3).




Figura 3

4. **A është korrekt dhe profesional komunikimi me zyrtarët e administratës, studentët kanë vlerësuar si në vijim:**

Sekretarët e njësive akademike: 770 studentë kanë vlerësuar me “shkëlqyeshëm”, 184 studentë kanë vlerësuar me “shumë mirë”, 227 studentë kanë vlerësuar me “mirë”, 132 studentë kanë vlerësuar me “mjaftueshëm”, ndërsa 201 studentë kanë vlerësuar me “dobët”. Në total, sekretarët e njësive akademike janë vlerësuar me mesatare 3.79 (figura 4).



Figura 4

Zyrtarët për Çështje Studentore (Referentët): 744 studentë kanë vlerësuar me “shkëlqyeshëm”, 229 studentë kanë vlerësuar me “shumë mirë”, 223 studentë kanë vlerësuar me “mirë”, 114 studentë kanë vlerësuar me “mjaftueshëm”, ndërsa 189 studentë kanë vlerësuar me “dobët”. Në total, zyrtarët për çështje studentore (referentët) janë vlerësuar me mesatare 3.82 (figura 5).




Figura 5

Zyrtarët e Teknologjisë së Informacionit – IT: 788 studentë kanë vlerësuar me “shkëlqyeshëm”, 209 studentë kanë vlerësuar me “shumë mirë”, 227 studentë kanë vlerësuar me “mirë”, 125 studentë kanë vlerësuar me “mjaftueshëm”, ndërsa 160 studentë kanë vlerësuar me “dobët”. Në total, zyrtarët e teknologjisë së informacionit – IT janë vlerësuar me mesatare 3.89 (figura 6).




Figura 6

Zyrtarët për Zhvillim të Karrierës: 748 studentë kanë vlerësuar me “shkëlqyeshëm”, 211 studentë kanë vlerësuar me “shumë mirë”, 223 studentë kanë vlerësuar me “mirë”, 125 studentë kanë vlerësuar me “mjaftueshëm”, ndërsa 177 studentë kanë vlerësuar me “dobët”. Në total, zyrtarët për zhvillim të karrierës janë vlerësuar me mesatare 3.83 (figura 7).




Figura 7

Zyrtarët e Protokolit dhe Arkivës: 744 studentë kanë vlerësuar me “shkëlqyeshëm”, 211 studentë kanë vlerësuar me “shumë mirë”, 233 studentë kanë vlerësuar me “mirë”, 129 studentë kanë vlerësuar me “mjaftueshëm”, ndërsa 164 studentë kanë vlerësuar me “dobët”. Në total, zyrtarët e protokolit dhe arkivës janë vlerësuar me mesatare 3.84 (figura 8).




Figura 8

Zyrtarët e Bibliotekës: 805 studentë kanë vlerësuar me “shkëlqyeshëm”, 188 studentë kanë vlerësuar me “shumë mirë”, 208 studentë kanë vlerësuar me “mirë”, 126 studentë kanë vlerësuar me “mjaftueshëm”, ndërsa 170 studentë kanë vlerësuar me “dobët”. Në total, zyrtarët e bibliotekës janë vlerësuar me mesatare 3.89 (figura 9).




Figura 9

5. Niveli i përmbushjes së kërkesave të studentëve nga zyrtarët përkatës është:

Sekretari i njësisë akademike: 729 studentë kanë vlerësuar me “shkëlqyeshëm”, 215 studentë kanë vlerësuar me “shumë mirë”, 234 studentë kanë vlerësuar me “mirë”, 141 studentë kanë vlerësuar me “mjaftueshëm”, ndërsa 175 studentë kanë vlerësuar me “dobët”. Në total, sekretarët e njësive akademike janë vlerësuar me mesatare 3.79 (figura 10).



Figura 10

Zyrtarët për Çështje Studentore (Referentët): 730 studentë kanë vlerësuar me “shkëlqyeshëm”, 227 studentë kanë vlerësuar me “shumë mirë”, 248 studentë kanë vlerësuar me “mirë”, 122 studentë kanë vlerësuar me “mjaftueshëm”, ndërsa 163 studentë kanë vlerësuar me “dobët”. Në total, zyrtarët për çështje studentore (referentët) janë vlerësuar me mesatare 3.83 (figura 11).




Figura 11

Zyrtarët e Teknologjisë së Informacionit – IT: 751 studentë kanë vlerësuar me “shkëlqyeshëm”, 212 studentë kanë vlerësuar me “shumë mirë”, 249 studentë kanë vlerësuar me “mirë”, 123 studentë kanë vlerësuar me “mjaftueshëm”, ndërsa 151 studentë kanë vlerësuar me “dobët”. Në total, zyrtarët e teknologjisë së informacionit – IT janë vlerësuar me mesatare 3.87 (figura 12).




Figura 12

Zyrtarët për Zhvillim të Karrierës: 728 studentë kanë vlerësuar me “shkëlqyeshëm”, 210 studentë kanë vlerësuar me “shumë mirë”, 247 studentë kanë vlerësuar me “mirë”, 126 studentë kanë vlerësuar me “mjaftueshëm”, ndërsa 168 studentë kanë vlerësuar me “dobët”. Në total, zyrtarët për zhvillim të karrierës janë vlerësuar me mesatare 3.81 (figura 13).




Figura 13

Zyrtarët e Protokolit dhe Arkivës: 738 studentë kanë vlerësuar me “shkëlqyeshëm”, 220 studentë kanë vlerësuar me “shumë mirë”, 244 studentë kanë vlerësuar me “mirë”, 121 studentë kanë vlerësuar me “mjaftueshëm”, ndërsa 148 studentë kanë vlerësuar me “dobët”. Në total, zyrtarët e protokolit dhe arkivës janë vlerësuar me mesatare 3.87 (figura14).




Figura 14

Zyrtarët e Bibliotekës: 777 studentë kanë vlerësuar me “shkëlqyeshëm”, 199 studentë kanë vlerësuar me “shumë mirë”, 226 studentë kanë vlerësuar me “mirë”, 121 studentë kanë vlerësuar me “mjaftueshëm”, ndërsa 163 studentë kanë vlerësuar me “dobët”. Në total, zyrtarët e bibliotekës janë vlerësuar me mesatare 3.88 (figura 15).




Figura 15

6. Përgjigjet në kërkesat e studentëve a merren parasysh me kohë nga:

Sekretari i njësisë akademike: 702 studentë kanë vlerësuar me “shkëlqyeshëm”, 217 studentë kanë vlerësuar me “shumë mirë”, 238 studentë kanë vlerësuar me “mirë”, 142 studentë kanë vlerësuar me “mjaftueshëm”, ndërsa 176 studentë kanë vlerësuar me “dobët”. Në total, sekretarët e njësive akademike janë vlerësuar me mesatare 3.76 (figura 16).



Figura 16

Zyrtarët për Çështje Studentore (Referentët): 724 studentë kanë vlerësuar me “shkëlqyeshëm”, 210 studentë kanë vlerësuar me “shumë mirë”, 254 studentë kanë vlerësuar me “mirë”, 131 studentë kanë vlerësuar me “mjaftueshëm”, ndërsa 170 studentë kanë vlerësuar me “dobët”. Në total, zyrtarët për çështje studentore (referentët) janë vlerësuar me mesatare 3.8 (figura 17).




Figura 17

Zyrtarët e Teknologjisë së Informacionit – IT: 738 studentë kanë vlerësuar me “shkëlqyeshëm”, 207 studentë kanë vlerësuar me “shumë mirë”, 257 studentë kanë vlerësuar me “mirë”, 125 studentë kanë vlerësuar me “mjaftueshëm”, ndërsa 161 studentë kanë vlerësuar me “dobët”. Në total, zyrtarët e teknologjisë së informacionit – IT janë vlerësuar me mesatare 3.83 (figura 18).




Figura 18

Zyrtarët për Zhvillim të Karrierës: 727 studentë kanë vlerësuar me “shkëlqyeshëm”, 214 studentë kanë vlerësuar me “shumë mirë”, 241 studentë kanë vlerësuar me “mirë”, 128 studentë kanë vlerësuar me “mjaftueshëm”, ndërsa 169 studentë kanë vlerësuar me “dobët”. Në total, zyrtarët për zhvillim të karrierës janë vlerësuar me mesatare 3.81 (figura 19).




Figura 19

Zyrtarëte Protokolit dhe Arkivës: 733 studentë kanë vlerësuar me “shkëlqyeshëm”, 223 studentë kanë vlerësuar me “shumë mirë”, 246 studentë kanë vlerësuar me “mirë”, 117 studentë kanë vlerësuar me “mjaftueshëm”, ndërsa 159 studentë kanë vlerësuar me “dobët”. Në total, zyrtarët e protokolit dhe arkivës janë vlerësuar me mesatare 3.85 (figura 20).




Figura 20

Zyrtarët e Bibliotekës: 780 studentë kanë vlerësuar me “shkëlqyeshëm”, 180 studentë kanë vlerësuar me “shumë mirë”, 237 studentë kanë vlerësuar me “mirë”, 123 studentë kanë vlerësuar me “mjaftueshëm”, ndërsa 162 studentë kanë vlerësuar me “dobët”. Në total, zyrtarët e bibliotekës janë vlerësuar me mesatare 3.87 (figura 21).




Figura 21

Rekomandimet për përmirësim, të propozuara nga Këshilli për Menaxhim të Cilësisë dhe Vlerësim:

1. Për sekretarët e njësive akademike:
Trajnim për menaxhim kohe dhe efikasitet administrativ
2. Për zyrtarët për çështje studentore (referentët):
Trajnim për etikën në komunikim
3. Për zyrën për zhvillim të karrierës:
Rritja e komunikimit me studentë, krijimi dhe publikimi i kalendarit të aktiviteteve
4. Për zyrtarët e IT-së:
Krijimi i platformes për digjitalizim të kërkesave të studentëve
5. Për zyrtarët e bibliotekës:
Promovim i shërbimeve online dhe orientime për shfrytëzimin e bibliotekës